



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 15 datë 07/03/1995

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur sot në dt.07.03.1995, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike për orët e punës të punonjësve të Wc-ve Publike që ndodhen në territorin e Ndërmarrjes së Pastrimit Nr.1, e cila ka kaluar në sipërmarrje me firmën Italiane Nuova Ecolega,

V E N D O S I

1. Të paguhen nga të ardhurat e Bashkisë punonjësit e Wc-ve Publike që ndodhen në territorin e administruar nga Ndërmarrja e Pastrimit Nr.1, derisa Axhensia K.Privatizimit pranë Bashkisë, të zgjidhi problemin e kontratave të dhënies me qera të objekteve.
2. Për zbatimin e saj ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria Administrimit Financiar e Bashkisë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA